



Datë: 16.07.2025
Numër Protokolli: 4792/2025

A.nr.630/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.630/2025, të datës 10.04.2025 të parashtruar nga ankuesi B.I, kundër organit të punësimit Ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.630/2025, e datës 10.04.2025, e parashtruar nga ankuesi B.I.
- II. Obligohet** Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij, në mënyrë që ankuesin të sistemoj në pozitë ekuivalente më pozitën që ka pasur sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 15.09.2017.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.I (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), më datë 10.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos sistemimit në një pozitë ekuivalente me pozitën që ka mbajtur sipas akt emërimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.04.2025, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje MINT), ndërsa kjo e fundit më datë 23.04.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 2368/2025 të datës 10.04.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimi dhe Plotësimi i aktit të emërimit i datës 15.09.2017; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim i datës 24.03.2017; Vendimin Ref.02/Nr.35 të datës 16.02.2024; Emailin e datës 16.02.2024 nga B.I për E.Z; Emailin e datës 20.02.2024 nga B.I për B.L; Emailin e datës 14.02.2025, 20.02.2025 nga ankuesi për Q.A; Emailin e datës 04.03.2025, 08.04.2025 nga ankuesi për S.Z; Diplomat e ankuesit; Certifikatat e ankuesit; Referencë e datës 10.02.2010, 27.02.2017; Vërtetimin e datës 28.08.2024; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 05.01.2007, 02.02.2007, 04.05.2009, 08.09.2008; Akt Emërimit e datës 31.01.2012; Vendimin 01.Ref.Nr.47 të datës 07.12.2020; Vendimin 01.Ref.Nr.18 të datës 02.02.2021; Vendimin 01 Ref.Nr.60 të datës 19.01.2022; Vendimin me Nr. Ref.01.10 të datës 14.02.2024; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë 17.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 23.04.2025; Emailin e datës 18.04.2025 nga S.Z për A.B; Emailin e datës 18.04.2025 nga A.B për A.Z; Vendimin me numër protokolli 3480/2025 të datës 26.05.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 15.09.2017, ankuesi është punësuar në pozitën Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim në Agjencinë e Kosovës për Standardizim.

Tutje sipas Vendimit ref.02/Nr.35 të datës 16.02.2024 të u.d Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, ankuesi është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Ndërmarrësisë për një periudhë të vlefshme për gjashtë (6) muaj e ky afat mund të zgjas më së shumti dhe për gjashtë (6) muaj tjerë.

Pas kalimit të afatit për caktim të ushtruesit të detyrës, ankuesi më datë 14.02.2025 ka njoftuar u.d Sekretaren e Përgjithshme të MINT, se më datë 16.02.2025 bëhet një vit prej kur jam transferuar, ndërsa me datës 20.02.2025 ka ripërsëritur kërkesën e tij, duke kërkuar që të sistemohet në një pozitë ekuivalente me pozitën që ka pasur meqë pozita sipas akt emërimit është shuar sipas Rregullores (ZKM) Nr.19/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizim e Vendeve të Punës në Agjencinë e Kosovës për Standardizim, gjithashtu përmes këtij emaili ka njoftuar se shpallja e konkursit të datës 19.02.2025 për pozitën Drejtor i Departamentit të Ndërmarrësisë por edhe konkurset tjera pa u kryer sistemimi im konsideroj si arsye që po ju shkruaj. Duke mos pranuar përgjigje në emailin e adresuar ankuesi më datë 08.04.2025, përmes emailit dërguar u.d Sekretares së Përgjithshme të MINT, se nuk ka pranuar asnjë vendim për sistemim të tij, një e drejtë që ja ka garantuar ligji.

Duke mos marr përgjigje në emailin e adresuar nga ankuesi, i njëjti ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas të cilës pretendon se me rastin e mos sistemimit janë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe dispozitave të tjera që rregullojnë materien. Kërkon që ankesa të aprovohet, të obligohet MINT që të nxjerr vendim për caktimin, emërimin një në pozitë ekuivalente më pozitën që ka mbajtur.

Në përgjigjen në ankesë të dërguar më datë 23.04.2025, u.d Sekretare e Përgjithshme në MINT, në emailin e datës 18.04.2025 konfirmon se meqë jemi në hartimin e përshkrimit të vendeve të punës ende nuk ka përfunduar procesi i sistemimit në MINT dhe ASK.

Ndërsa lidhur me caktimin e ushtruesve të detyrës Kolegji i Këshillit, mori për bazë nenit 35, ku përcaktohet: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.*

Bazuar në kuadrin ligjor si më lartë, në çdo rrethanë kur nëpunësi civil kur caktohet ushtrues detyre i një pozite tjetër, me kalimin e afatit kthehet në pozitën e mëparshme që ka mbajtur sipas aktit të emërimit, mirëpo në rrethanat e rastit të ankuesit, kemi një situatë ku në kohën sa ankuesi ka qenë i transferuar, Kryeministri i Republikës së Kosovës përmes Vendimit me Nr.187/2024 të datës 15.11.2024 ka miratuar Rregulloren (ZKM) Nr.19/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizim e Vendeve të Punës në Agjencinë e Kosovës për Standardizim. Sipas Rregullores (ZKM) Nr.19/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizim e Vendeve të Punës në Agjencinë e Kosovës për Standardizim, me nenin 4 është paraparë struktura organizative e Agjencisë Kosovare për Standardizim është si vijon: Drejtori Ekzekutiv; 1.2. Divizionet, ndërsa me nenin 6 janë paraparë këto divizione: Divizioni për Standarde; Divizioni për Promovimin e Standardeve dhe Integrimin në Organizatat e Standardizimit dhe Divizioni për Aftësim dhe Certifikim me Standarde, me çka nënkupton se pozita e ankuesit që ka mbajtur sipas akt emërimit nuk është paraparë por nuk janë paraparë as pozitë Drejtor Drejtorati.

Sipas Kolegji të Këshillit, dhe duke marr parasysh të gjitha konstatimet si më sipër, dhe duke qenë se procesi i sistematizimit të vendeve të punës në MINT dhe Agjencinë e Standardizimit nuk ka përfunduar, atëherë, Kolegji i Këshillit, konstaton se duke qenë se MINT ka të miratuar Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e cila është ndryshuar dhe plotësuar sipas Rregullores (ZKM) N. 20/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe Agjencia për Standardizim e Kosovës ka të miratuar Rregulloren (ZKM) Nr.19/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Kosovës për Standardizim, kështu që në këto rrethana kjo ministri/agjenci i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, dhe përderisa i nënshtrohet këtij procesi, Kolegji i Këshillit, vlerëson shpallja e konkurseve për pozitat të kategorisë së ulët drejtues dhe të mese drejtues, cenon sigurinë juridike të nëpunësve brenda institucioneve respektive, e në këtë rast duhet marr parasysh dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave.*

Përkritazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, duke konstatuar se ankuesi ka plotësuar kushtin e caktimit si ushtrues i detyrës prej një (1) viti, atëherë sipas dispozitave ligjore në fuqi në përfundim të këtij afati, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme dhe përderisa ankuesi nuk është sistemuar pas kalimit të kësaj periudhë, atëherë janë cenuar parimet e marrëdhënies së punës së ankuesit ndërlidhur me parimet e menaxhimit të marrëdhënies së punës së zyrtarit publik të përcaktuar sipas nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe*

performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit, mirëpo Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë pozita e ankuesit është shuar, atëherë bazuar në pikëpamjet e këtij vendimi të thëna në dispozitiv dhe arsyetim të këtij vendimi, Sekretarja e Përgjithshme e MINT, është e obliguar që të ndërmarr të gjitha veprimet për sistemimin e ankuesit në pozitë ekuivalente me pozitën që ka mbajtur dhe në pozitë që plotëson kërkesat e përgjithshme formale për të.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2. të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda, me numër A.nr.630/2025**

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit B.I;*
- *Organit të punësimi: Sekretarit të Përgjithshëm, Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ristrukturimit në MINT;*
- *Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në MPB, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*